



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-346/07-63186/21, më 07. 04. 2021

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17, paragrafi 7 i Ligjit nr. 04/L-179, për transportin rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 21/13, qershor 2013), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për zgjatjen e linjës së autobusit nr. 15 Prishtinë - Keqekollë edhe për 9 km të tjera.
- II. Linja e cekur në pikën I të këtij vendimi zgjatet deri te kryqëzimi i rrugës Dabishec - Gllgovicë.
- III. Vend ndaljet për këto 9 km shtesë janë si në vijim:
 - Në afërsi të kryqëzimit të rrugës Prapashticë - Mutivodë (magjistranja M9);
 - Te Përmendorja e Dëshmorit "Ismet Asllani";
 - Në afërsi të rrugës "Fluri" (Lagja Fezovit);
 - Në afërsi kryqëzim të rrugës Dabishec - Gllgovicë.
- IV. Përgjegjës për funksionimin e kësaj linje si në pikën III të këtij Vendimi është ndërmarrja publike lokale "Trafiku Urban". Sh.a.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- NPL "Trafiku Urban",
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti